

**STATUTI**  
**I**  
**DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË NË SHQIPËRI**

**KREU I**

**Neni 1**  
**Emri dhe Vula**

1. Emri i Shoqatës është “Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri” (“Dhoma”).
2. Dhoma ka vulën, logon dhe emblemën identifikuese të saj, një riprodhim i së cilës është bashkëngjitur si Shtojca 1.

**Neni 2**  
**Selia**

1. Dhoma ka rezidencën e saj në Shqipëri. Selia ndodhet në Tiranë, në adresën e mëposhtme:  
Rr.“Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Suita 113, Tiranë.
2. Dhoma mund të krijojë degë kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Dhomës është e pakufizuar.

**Neni 4**  
**Objektivat**

1. Dhoma është një shoqatë jo-fitimprurëse, qëllimet e së cilës janë:
  - a. Të çojë përpara zhvillimin e tregtisë ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë;
  - b. Të zhvillojë marrëdhënie ekonomike reciprokisht të dobishme midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë;
  - c. Të zhvillojë marrëdhënie ekonomike me Evropën dhe marrëdhënie të tjera ekonomike që janë të destinuara të jenë reciprokisht të dobishme për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërinë;
  - d. Të nxisë zhvillimin ekonomik kombëtar dhe të japë kontribute të tjera për të mirën e Shqipërisë dhe rajonit të saj;
  - e. Të monitorojë legjislacionin dhe politikën e Shteteve të Bashkuara që ndikojnë në konkurrencën e biznesit të Shteteve të Bashkuara jashtë vendit, në veçanti, por jo ekskluzivisht, në lidhje me zhvillimet ekonomike në Shqipëri;
  - f. Të monitorojë, analizojë dhe të ndërmarrë veprime për legjislacionin dhe politikën shqiptare që ndikojnë biznesin dhe zhvillimin ekonomik.
  - g. Të promovojë interesat e anëtarëve të saj në tregtinë ndërmjet dhe në të dy vendet;
  - h. Të nxisë, inkurajojë dhe lehtësojë Tregtinë dhe Biznesin për anëtarët e saj në vend dhe më gjerë;

- i. Të promovojë praktikat më të mira amerikane tek komuniteti i biznesit që operon në Shqipëri.
2. Veprimet e Dhomës nuk do të kryhen me qëllimin për të bërë fitime, por mund të përfshijnë dhënien e shërbimeve për anëtarët e saj në përputhje me objektivat e mësipërme në këmbim të shpërblimit.

## **Neni 5**

### **Aktivitetet e Dhomës**

1. Dhoma ndihmon bizneset e Shteteve të Bashkuara dhe individët në aktivitetin e tyre të biznesit në Shqipëri.
2. Dhoma shërben si pikë reference për informacione biznesi të të gjitha llojeve.
3. Dhoma çon më tej interesat e Dhomës së Tregtisë së Shteteve të Bashkuara dhe rrit besueshmërinë e saj në Shqipëri.
4. Dhoma zhvillon dhe ruan marrëdhënie me Dhomën e Tregtisë së Shteteve të Bashkuara dhe Dhoma të tjera të tregtisë dhe organizata tregtare në të gjithë botën (duke përfshirë, por jo duke u kufizuar në organizata të vendeve të tjera të anëtarësuara në Dhomën e Tregtisë së SHBA-së).
5. Dhoma ndihmon Dhomën e Tregtisë së SHBA-së në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe programeve të saj në Shqipëri.
6. Dhoma ndihmon në koordinimin e pikëpamjeve të bizneseve amerikane në Shqipëri për një sërë politikash, programesh dhe çështjesh, të cilat i paraqet për rishikim herë pas here në Dhomën e Tregtisë së SHBA-së.
7. Dhoma organizon dhe përgatit ose harton raporte dhe anketa lidhur me klimën për bizneset amerikane në Shqipëri.
8. Dhoma analizon ndryshimet dhe zhvillimet e ligjeve, politikave dhe rregulloreve të qeverisë shqiptare që ndikojnë në biznes.
9. Dhoma organizon dhe pret seminare dhe aktivitete të tjera që do të ndihmojnë Dhomën për të përmbushur objektivat e saj.
10. Dhoma e ushtron veprimtarinë e saj përmes lobimit me qeverinë shqiptare dhe/ ose subjekte të tjera ligjore, entitete tregtare ose jo tregtare.
11. Dhoma kryen programet e bashkëpunimit biznes-qeveri.
12. Dhoma i përgjigjet kërkesave për informacion, kontrolleve të referencave të biznesit dhe takimeve për vizitorët biznesmenë në Shqipëri, në veçanti, por pa kufizim, atyre të rekomanduara nga Dhoma e Tregtisë në SHBA.
13. Dhoma promovon dhe inkurajon bisedimet dhe marrëveshjet tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe.
14. Dhoma realizon takime me zyrtarë qeveritarë shqiptarë dhe të SHBA-ve dhe njerëz të biznesit në lidhje me çështjet e të bërit biznes në Shqipëri apo me ndonjë nga objektivat e tjera të saj.
15. Dhoma ndërmerret çdo veprim tjetër të ligjshëm që do të ndihmojë Dhomën për të përmbushur objektivat e saj.
16. Dhoma ka të drejtë që të ketë publikimet e veta të cilat i shërbejnë qëllimit të saj, si gazetat, Librat Vjetorë, Raportet Vjetore, Të Dhënat Statistikore, Broshurat dhe gjithashtu ka të drejtë që të ketë faqen e saj në Web, Facebook, llogari në Twitter, dhe në rrjetet e tjera sociale, siç do të vendoset nga Bordi i Dhomës së Tregtisë. Secili nga këto publikime mund të mbështetet me reklamime nga anëtarët, ose jo anëtarët për një tarifë më të lartë.

## **Neni 6**

### **Politikat dhe Programet e Dhomës**

1. Roli i Dhomës do të jetë përfaqësimi i interesave të gjera të anëtarësisë, në adresimin e politikave dhe çështjeve rregullatore të cilat ndikojnë në klimën e biznesit.
2. Dhoma mund të marrë rolin e një “ndërmjetësi të veçantë” në emër të një industrie të veçantë ose hapësire gjeografike të caktuar, duke u pozicionuar mbi një çështje në interes vetëm të asaj industrie ose hapësire gjeografike.
3. Në çdo rast dhe kurdoherë, politikat dhe programet e Dhomës do të jenë në mbështetje të objektivave dhe në përputhje me strukturën e përcaktuar në Nenin 4.

## **Neni 7**

### **Burimet Financiare**

1. Dhoma përgatit buxhetin vjetor çdo vit kalendarik.
2. Dhoma ka burimet e mëposhtme financiare për të zhvilluar aktivitetet e saj:
  - a) kuota dhe kontribute të anëtarësisë;
  - b) dhurime nga persona të lejuar juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj;
  - c) të ardhura nga shërbimet e Dhomës;
  - d) të ardhura nga reklamimi; dhe
  - e) dhe/ose burime të tjera të ligjshme.
3. Dhoma nuk do të pranojë asnjë ndihmë financiare nga ndonjë qeveri ose agjenci e saj, ose nga çdo burim tjetër, i cili do të synonte kufizimin e lirisë së veprimit të Dhomës.
4. Dhoma nuk është e lejuar të kryejë asnjë formë shpërndarje të fitimeve, financiare dhe materiale, të krijuara nga të ardhurat e Dhomës.

## **Neni 8**

### **Anëtarët e Dhomës**

1. Personat fizikë dhe juridikë, të huaj dhe shqiptarë, të regjistruar në regjistrin tregtar, organizata joqeveritare dhe shoqata, të regjistruar ligjërisht në regjistrin e gjykatës, mund të jenë anëtarë të Dhomës mbi baza vullnetare.
2. Një aplikant për anëtarësim duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë Dhomës.
3. Për të marrë pranimin, një aplikant për anëtarësim duhet të miratohet me një shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të Bordit të Dhomës, me kushtin që nëse një aplikant i tillë ka kryer ndonjë nga veprimet që do ta përjashtonin atë me pikën 10, atëherë një aplikim i tillë do të refuzohet automatikisht.
4. Të gjithë anëtarët kanë të drejtë të shfrytëzojnë shërbimet e Dhomës në bazë të kategorisë që ata i përkasin.
5. Anëtari i miratuar do të emërojë përfaqësuesin/sit e tij për ta përfaqësuar atë.
6. Bordi i Drejtorëve do të vendosë, herë pas here, kuotat dhe taksat që do të kërkohen për anëtarësim.

## **Neni 9**

### **Anëtarësia**

1. Një anëtar mund të përjashtohet nga Dhoma për sjellje të pandershme ose të dëmshme ndaj objektivave dhe qëllimeve të Dhomës ose për dështim në plotësimin e kërkesave të Statutit ose aktet nënligjore të Dhomës.
2. Anëtarësimi në Dhomë do të përfundojë nëse anëtari pushon së ekzistuari si person juridik.
3. Përjashtimi i një anëtari do të vendoset nga dy të tretat e shumicës së votave të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të pranishëm në takim, duke parashtruar me shkrim arsyet mbi të cilat është bazuar propozimi.
4. Anëtarit në fjalë do t'i jepet një mundësi për të mbrojtur veten e tij/ saj përpara takimit të Bordit të Drejtorëve.
5. Një anëtar konsiderohet i rregullt, nëse kuotat dhe detyrimet e tij/saj janë paguar plotësisht brenda datës.
6. Një anëtar mund të japë dorëheqjen nga Dhoma në çdo kohë duke paraqitur dorëheqjen e tij/ saj me shkrim në selinë e Dhomës.

### **Neni 10** **Përjashtimi Automatik**

Nëse një anëtar i Dhomës:

- a) Klasifikohet nga Departamenti i Shtetit ose ndonjë autoritet tjetër qeveritar i SH.B.A.-së si person dhe/ose organizatë e përfshirë në korrupsion, ryshfete, veprimtari terroriste, ose veprimtari të tjera të dëmshme për sigurinë kombëtare të Shqipërisë dhe/ose SHBASë;
- b) është shpallur fajtor nga një gjykatë në çdo juridiksion, dhe një vendim i tillë: a. Nuk mund të apelohej më tej; dhe b. Përbën një krim; ose
- c) gënjen në aplikimin e tij të anëtarësimit rreth faktit që anëtari në fjalë është shpallur fajtor për një krim; atëherë:

Anëtari në fjalë do të përjashtohet automatikisht nga Dhoma dhe anëtarësia e tij do të përfundojë menjëherë. Përfundimi në fjalë do të komunikohet në mbledhjen e ardhshme të Bordit dhe do të regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes. Në rast se anëtari në fjalë shërben gjithashtu si anëtar i Bordit dhe/ose në ndonjë prej komiteteve të Dhomës, të gjitha funksionet e tilla do të përfundojnë automatikisht pa pasur nevojë për ndonjë veprim të mëtejshëm.

### **Neni 11** **Forca Madhore**

Për qëllimet e këtij Statuti, forcë madhore do të thotë çdo akt, ngjarje, veprim ose mosveprim që ndodh dhe që nuk mund të parashikohet ose kontrollohet në mënyrë të arsyeshme. Në përdorimin e këtushëm, forca madhore përfshin, pa kufizime, akte të Zotit, tërmete, zjarre, përmbajtje, luftëra, trazira civile ose ushtarake, akte terrorizmi, sabotime, greva, epidemi, pandemi, trazira, ndërprerje të energjisë elektrike, dështime kompjuterike dhe rrethana të tjera përtej kontrollit të arsyeshëm të cilat mund të shkaktojnë ndërprerje, humbje ose mosfunksionim të shërbimeve të furnizimit me energji elektrike dhe ujë, të transportit, kompjuterike (pajisjeve ose softuerit) ose shërbimit të komunikimit telefonik, aksidente, mosmarrëveshje sindikale, akte të autoriteteve civile ose ushtarake, veprime qeveritare ose pamundësi për të marrë fuqi punëtore, materiale, pajisje ose transport. (referuar në vijim si “**Forca madhore**”).

## **KREU II** **ORGANET E DHOMËS**

### **Neni 12**

## **Asambleja**

1. Asambleja përbëhet nga të gjithë anëtarët e rregullt të Dhomës.
2. Asambleja:
  - a) Aprovon Statutin e Dhomës dhe nenet e tij, si dhe çdo amendament të këtyre dokumentave siç është propozuar nga Bordi i Drejtorëve;
  - b) Zgjedh Bordin e Drejtorëve; dhe
  - c) Vendos për mbylljen e Dhomës.

### **Neni 13**

#### **Takimet e Asamblesë dhe Vendimmarrja**

1. Asambleja thirret nga Bordi i Drejtorëve, Presidenti i Dhomës ose me kërkesën e 1/5 të anëtarëve të rregullt të Asamblesë.
2. Asambleja mbledhet rregullisht, duke përfshirë një takim vjetor, të paktën një herë në vit jo më vonë se data 30 Prill e vitit kalendarik.
3. Në çdo mbledhje të Asamblesë, kuorumi konsiston në të paktën 1/2 e të gjithë anëtarëve të rregullt të Dhomës të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë. Me përjashtim të rastit të parashikuar në paragrafin 4, vendimet merren nga shumica e anëtarëve të rregullt të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë në një takim ku realizohet kuorumi. Kërkesa për të qënë “të pranishëm personalisht” nuk do të jetë e nevojshme në rast se zbatohen mënyra të tjera të takimit, siç parashikohet në Nenin 23 të këtij Statuti.
4. Prokura duhet t’i jepet dikujt tjetër, i cili nuk voton në Asamblese.
5. Çdo ndryshim apo shtesë në Statutin e Dhomës, mbyllja e aktivitetit të Dhomës kërkon një shumicë votash prej dy të tretave të anëtarëve të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë. Kërkesa për të qënë “të pranishëm personalisht” nuk do të jetë e nevojshme në rast se zbatohen mënyra të tjera të takimit, siç parashikohet në Nenin 23 të këtij Statuti.
6. Të gjithë anëtarët e Dhomës të cilët kanë të drejtën e votës dhe janë anëtarë të rregullt kanë të drejtën e një vote në çdo takim të Asamblesë.
7. Asambleja mund të veprojë edhe pa u mbledhur nëse të gjithë anëtarët, të cilët janë të rregullt janë dakord që të japin aprovimin e tyre me shkrim për ndërmarrjen e veprimit.

### **Neni 14**

#### **Bordi i Drejtorëve**

1. Dhoma drejtohet dhe administrohet nga Bordi i Drejtorëve (Bordi). Bordi përbëhet nga 7 anëtarë. Një Drejtor, me detyrë aktuale në Bordin e Dhomës të Tregtisë Amerikane, nuk mund të mbajë njëkohësisht pozicion tjetër drejtues apo ekzekutues në Dhoma të tjera të Tregtisë apo organizata të ngjashme. Këto pozicione janë të papajtueshme.
2. Drejtorit i ndalohe të bëjë publike ose të përdorë informacion konfidencial të fituar gjatë detyrës si Drejtor i Bordit të AmCham-it.
3. Anëtarët e Bordit do të bëjnë të ditur të gjithë konfliktet e interesit aktuale apo të mundshme, në çdo kohë që mund të ndodhin ose nëse do të ndodhin, në vëmendje të gjithë Bordit dhe i përmbahen rekomandimit të Bordit ose japin dorëheqje nga Bordi brenda 30 ditëve nga njoftimi me shkrim.
4. Anëtarët e Bordit, të cilët janë, Presidenti, Zëvendëspresidenti, Financieri, Sekretari dhe anëtarë të tjerë të vendosur nga Asambleja, zgjidhen nga Asambleja çdo dy vjet. Anëtarët e Bordit mund të rizgjidhen

për një maksimum prej dy mandatesh të njëpasnjëshme. Afatet kohore janë të zbatueshme si për individët ashtu edhe për kompanitë.

5. Anëtarët e Bordit mund të shërbejnë për një mandat fillestar jo më shumë se 2 (dy) vjet. Secili anëtar i Bordit mund të rizgjidhet si anëtar i Bordit për jo më shumë se 2 (dy) mandate shtesë radhazi prej 2 (dy) vitesh secili, dhe secili anëtar i Bordit nuk mund të shërbejë në Bord për më shumë se 3 (tre) mandate radhazi. Kufizime të tilla kohore zbatohen si për individët ashtu edhe për kompanitë, dhe individët nuk mund t'i anashkalojnë këto kufizime duke përfaqësuar një anëtar tjetër të Dhomës si anëtar i Bordit.
6. Secili anëtar i Bordit, si individ dhe si kompani, nuk mund të aplikojë për t'u zgjedhur dhe nuk do të shërbejë përsëri si anëtar i Bordit për një periudhë që është jo më pak se 6 (gjashtë) vjet nga data e fundit kur ai individ/ajo kompani shërbeu si anëtar/e e bordit.
7. Presidenti ose Zëvendëspresidenti duhet të jetë shtetas Amerikan ose Presidenti duhet të jetë përfaqësuesi i një firme Amerikane. Shumica e anëtarëve të Bordit duhet të jenë shtetas Amerikane ose përfaqësues të firmave Amerikane. Presidenti ose Zëvendëspresidenti mund të mos jetë shtetas Amerikan, për sa kohë njëri nga ata është përfaqësues i firmave Amerikane, dhe Bordi aprovon aplikimin paraprakisht.
8. Përveç kërkesave të sipërpërmendura, kandidati për President i Bordit duhet të ketë shërbyer së paku 1 (një) mandat si anëtar i Bordit. Në rast se një kandidat që aplikon për të kandiduar për President të Bordit nuk ka shërbyer më parë si anëtar i Bordit, një kandidaturë e tillë duhet të miratohet me të paktën 2/3 e votave të Bordit përpara se emri në fjalë të vendoset në fletën e votimit në zgjedhjet përkatëse në Asamblenë e Përgjithshme.
9. Një person nuk mund të mbajë më shumë se një pozicion.
10. Një anëtar i Bordit mund të dorëhiqet nga Bordi në çdo kohë, duke dërguar njoftimin e dorëheqjes me shkrim në selinë e Dhomës.
11. Nëse një anëtar i Bordit nuk paraqitet në dy ose më shumë takime radhazi të Bordit – përjashtuar rrethanat e jashtëzakonshme që pranohen nga shumica e anëtarëve të mbetur të Bordit - ose një anëtar i Bordit nuk merr pjesë në më shumë se tre takime të Bordit në një vit, atëherë ky veprim do të konsiderohet nga Bordi si një dorëheqje e kryer.
12. Bordi do të plotësojë vendin vakant të krijuar nga dorëheqja ose largimi në datën më të afërt të mundshme, nga shumica e votave të anëtarëve të mbetur të Bordit, me anëtarin e zgjedhur për zëvendësim për të shërbyer deri në Mbledhjen tjetër të Asamblesë së Përgjithshme, në punimet e së cilës Bordi do të jetë subjekt i zgjedhjes nga anëtarët e rregullt.
13. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve mbajnë pozicionet në sajë të cilësisë së tyre të të qenit përfaqësues anëtar të AmCham. Anëtari i Bordit të Drejtorëve do të pushojë së mbajturi pozicionin nëse ai/ ajo pushon së qeni përfaqësues i anëtarit të AmCham-it që ai/ajo përfaqësonte kur ishte zgjedhur, me përjashtim kur ai/ajo me efekt të menjehershëm përfaqëson një tjetër anëtar të AmCham-it, i cili nuk ka një përfaqësues në Bordin e Drejtorëve.
14. Zëvendësambasadori dhe Atasheu Tregtar i Ambasadës Amerikane do të jenë anëtarë vëzhgues *ex-officio* të Bordit pa të drejtë vote.

## **Neni 15**

### **Bordi Fillestar i Drejtorëve**

1. Bordi i parë përbëhet nga pesë anëtarë, katër prej të cilëve do të jenë përkatësisht, Presidenti, Zëvendëspresidenti, Financieri dhe Sekretari.  
Bordi do të përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë deri në momentin që do të ndryshohet nga Asambleja.
2. Bordi fillestar i Drejtorëve përbëhet nga
  1. Krenar Loloçi, President

2. Charles W. Levesque, Zëvendëspresident
  3. Lorenzo Roncari, Financier
  4. Nick Karas, Sekretar
  5. Gary A. Moinette, Anëtar
3. Ky Bord fillestar i Drejtorëve do të veprojë si Bordi i Drejtorëve deri në takimin e parë të Asamblesë, që do të mbahet jo më vonë se një muaj pas krijimit të Dhomës.

## **Neni 16**

### **Funksionet e Bordit**

1. Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për drejtimin e Dhomës;
2. Bordi aprovon buxhetin e Dhomës dhe amendamentet e tij;
3. Bordi aprovon statutin fillestar;
4. Bordi aprovon strukturën dhe personelin e Dhomës dhe vendos pagat dhe shpërblimet e të gjithë të punësuarve të Dhomës;
5. Bordi cakton dhe shkarkon Drejtorin Ekzekutiv me një shumicë absolute të anëtarëve;
6. Bordi aprovon të gjitha raportet dhe studimet rreth klimës së biznesit Amerikan në Shqipëri përpara se të publikohen;
7. Bordi vendos përjashtimin e anëtarëve të Dhomës si dhe pranimin e tyre gjithashtu edhe propozimet për ndryshime në Statut.
8. Bordi cakton çdo vit një audit të pavarur për të audituar gjendjen financiare të Dhomës. Pas shqyrtimit të llogarive dhe regjistrave të Dhomës, auditit do t'i dërgojë një raport me shkrim Bordit të Drejtorëve për prezantim në Mbledhjen Vjetore të Asamblesë.
9. Bordi vendos anëtarët e përhershëm të Komiteteve të Dhomës dhe zgjedh Kryetarët e tyre siç përcaktohet në Nenin 22.
10. Për sa kohë që nuk bie ndesh me përmbajtjen e këtij Statuti çdo detyrë që nuk i është deleguar në mënyrë të qartë në Statut një organi tjetër të Dhomës mbetet përgjegjësi e Bordit.
11. Bordi miraton punësimin dhe shkarkimin e (1) Drejtorit Ekzekutiv dhe (2) me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv, të Menaxherit të Politikave dhe Advokimit. Bordi miraton strukturën e Ekipit Drejtues.
12. Presidenti, Zëvendës presidenti, Financieri dhe Sekretari do të kenë autoritetin për të deleguar për një periudhë të caktuar kohe disa nga detyrat dhe/ose përgjegjësitë e tyre tek një anëtar tjetër i Bordit ose një anëtar i stafit ekzekutiv. Një delegim i tillë do të hyjë në fuqi me miratimin e Bordit dhe mund të tërhiqet nga anëtari delegues i Bordit ose Bordi në çdo kohë. Aprovimi i Bordit nuk kërkohet kur anëtari delegues i Bordit tërheq delegimin. Një delegim i tillë përfundon automatikisht me përfundimin e mandatit të anëtarit delegues të Bordit. Autorizimi për të deleguar nuk zbatohet në rast se Presidenti mungon plotësisht; në këtë rast, zinxhiri i caktuar i drejtimit të vendosur në Statut mbetet në fuqi.
13. Bordi i Drejtorëve mund të vendosë kategori të ndryshme anëtarësie, me taksa dhe tarifa të ndryshme, duke patur parasysh se do të ketë një bazë arsyetimi për kategoritë e ndryshme dhe se anëtarët brenda një kategorie do të trajtohen në mënyrë të barabartë.
14. Detyrimet për anëtarësimin duhet të parapagohen për secilin vitin kalendarik.

## **Neni 17**

### **Rregullat e Funksionimit të Bordit**

1. Bordi mbledhet rregullisht të paktën një herë në tre muaj. Mbledhjet e Bordit thirren nga Presidenti, ose nga 1/3 e anëtarëve të Bordit aktualisht në detyrë.
2. Drejtori Ekzekutiv u shpërndan axhendën e propozuar të çdo takimi anëtarëve të Bordit të paktën pesë ditë pune përpara datës së takimit, ose nëse bëhet fjalë për një mbledhje të jashtëzakonshme, sa më shpejt përpara mbledhjes. Asnjë çështje e paparashikuar në rendin e ditës të një mbledhjeje jashtë radhe të dërguar nga Drejtori Ekzekutiv nuk mund të shqyrtohet, përveç rasteve kur të gjithë anëtarët e Bordit japin aprovimin e tyre.
3. Mbledhja e Bordit është e vlefshme nëse më shumë se gjysma e anëtarëve janë të pranishëm personalisht. Kërkesa për të qënë “të pranishëm personalisht” nuk do të jetë e nevojshme në rast se zbatohen mënyra të tjera të takimit, siç parashikohet në Nenin 23 të këtij Statuti.
4. Bordi merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të cilët janë të pranishëm personalisht, me përjashtim të vendimit për të shkarkuar ose marrë masa disiplinore ndaj Drejtorit Ekzekutiv që do të merret vetëm nga një shumicë absolute e anëtarëve në detyrë të Bordit.
5. Procesverbalet mbahen në çdo mbledhje të Bordit dhe ruhen në selinë e Dhomës.
6. Çdo vendim i Bordit që bie ndesh me dispozitat e këtij Statuti është i pavlefshëm.
7. Nëse Bordi dështon në realizimin e një mbledhjeje brenda një periudhe gjashtë mujore, atëherë ai shpërbëhet automatikisht. Nëse do të ndodhë kjo, të paktën 10 % e anëtarëve të rregullt kanë të drejtë të thërrasin Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë me qëllim zgjedhjen e Bordit të ri të Drejtorëve.

### **Neni 18**

#### **Presidenti dhe Zëvendës-presidenti i Bordit**

1. Presidenti i Bordit është në të njëjtën kohë dhe President i Dhomës.
2. Presidenti është përfaqësuesi ligjor i Dhomës.
3. Presidenti kryeson mbledhjet e Asamblesë dhe të Bordit.
4. Presidenti bashkëpunon me Sekretarin dhe Drejtorin Ekzekutiv për çdo çështje dhe ai gjithashtu nënshkruan korrespondencën e përgjithshme.
5. Në rast mungese ose kur lindin probleme të tjera gjatë ushtrimit të detyrës nga Presidenti, Zëvendës-presidenti zëvendëson Presidentin në të gjitha detyrat e tij.

### **Neni 19**

#### **Drejtori Ekzekutiv**

1. Drejtori Ekzekutiv drejton dhe është përgjegjës përpara Bordit dhe Presidentit për aktivitetet e Dhomës, duke përfshirë veprimet e përditshme.
2. Drejtori Ekzekutiv drejton gjithë aktivitetin, shërbimet dhe stafin e Dhomës, ai/ ajo koordinon dhe menaxhon biznesin e Dhomës.
3. Drejtori Ekzekutiv (1) është përgjegjës për punësimin dhe shkarkimin e punonjësve dhe (2) i propozon Bordit kandidatin/tët për Menaxher të Politikave dhe Advokimit.
4. Drejtori Ekzekutiv përgatit projekt buxhetin.
5. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të mbledhë fonde, të cilat, pasi mbledhen, behën pjesë e buxhetit të Dhomës.
6. Drejtori Ekzekutiv i raporton Bordit jo më pak se një herë në muaj, ai/ ajo është i/ e detyruar t'i raportojë Bordit në çdo kohë që kërkohet nga Bordi.
7. Drejtori Ekzekutiv emëron dhe shkarkon punonjësit dhe i raporton vendimet e tij Bordit të Dhomës.



8. Drejtori Ekzekutiv mban të gjitha komunikimet publike në emër të dhomës. Në rast të veçantë kur Drejtori Ekzekutiv nuk është në gjendje ta bëjë këtë, Presidenti do ta kryejë këtë detyrë në emër të Drejtorit Ekzekutiv.

## **Neni 20**

### **Financieri**

1. Financieri do të jetë përgjegjës për të gjitha fondet e mbledhura dhe të shpenzuara për veprimet e Dhomës, si edhe për pronat dhe asetet e saj.
2. Financieri mund të kërkojë, në çdo kohë, që Drejtori Ekzekutiv t'i japë atij/ asaj raportet financiare, për rishikim dhe referim të mundshëm Bordit.
3. Financieri do të njoftojë menjëherë Bordin për çdo shqetësim që mund të ketë lidhur me fondet e tërhequra nga çdo llogari e Dhomës. Ai/ Ajo do të sugjerojë veprime korigjuese nëse shqetësime të tilla vërtetohen.

## **Neni 21**

### **Sekretari**

1. Sekretari i Dhomës mban një raport të plotë të procedurave të Asamblesë dhe mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe raporton përfundimet në çdo mbledhje të Bordit të Drejtorëve.
2. Sekretari mban vulën dhe regjistrin e Dhomës.
3. Sekretari harton axhendën e mbledhjeve të Asamblesë dhe të Bordit të Drejtorëve.
4. Sekretari është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e Dhomës përveç dokumenteve financiare.
5. Sekretari është përgjegjës për korrespondencën e Dhomës.
6. Sekretari së bashku me Presidentin dhe Drejtorin Ekzekutiv, janë të angazhuar në koordinimin e programeve të Dhomës.
7. Në mungesë të Presidentit dhe Zëvendëspresidentit, Sekretari do të ketë të njëjtat fuqi si Presidenti.

## **Neni 22**

### **Komitetet e Përhershme**

1. Dhoma ka Komitetet e Përhershme, të cilat janë krijuar nga Bordi i Drejtorëve të Dhomës.
2. Kryetarët e Komiteteve zgjidhen më shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e Bordit të pranishëm në takim. Çdo Komitet duhet të përbëhet nga jo më pak se 4 anëtarë.
3. Mbledhjet e Komiteteve do të drejtohen nga Kryetarët siç kërkohet. Kryetarët e Komiteteve i raportojnë rregullisht Bordit të Drejtorëve, jo më pak se katër herë në vit (të paktën një herë në katër muaj). Më shumë se 50 për qind e anëtarëve të përhershëm do të krijojnë një kuorum dhe anëtarët e përhershëm të një Komiteti, të cilët nuk marrin pjesë në tre mbledhje radhazi do të konsiderohen të dorëhequr nga Komiteti dhe vendi vakant mund të plotësohet nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ka të drejtën të thërrasë një mbledhje me cilindo komitet në çdo kohë.
4. Kryetarët e Komiteteve raportojnë rregullisht përpara Bordit të Drejtorëve, me shkrim ose personalisht, jo më pak se katër herë në vit (jo më pak se një herë në fund të çdo tremujori).
5. Çdo Komitet i dërgon Dhomës një raport vjetor të shkruar për t'u paraqitur në Mbledhjen Vjetore të Asamblesë.
6. Drejtori Ekzekutiv i Dhomës ose një person i caktuar nga stafi do të shërbejë si koordinator i çdo Komiteti.

## **Neni 23**

### **Mbledhjet Elektronike**

1. Për sa kohë që nuk bie ndesh me përmbajtjen e këtij Statuti në rastet e Forcës Madhore, Bordi mund të përcaktojë që mbledhjet e domosdoshme të Dhomës, përfshirë mbledhjet e Asamblesë, të Bordit dhe ato të Komiteteve, mund të mbahen tërësisht me anë të mjeteve telefonike, elektronike ose formave të tjera të komunikimit që lejojnë numrin maksimal të pjesëmarrësve të komunikojnë në mënyrë adekuate me njëri-tjetrin gjatë takimit. Bordi do të vendosë procedurat për mbajtjen e këtyre mbledhjeve, duke përfshirë, pa kufizim, procedurat për votim përmes mjeteve telefonike, elektronike ose formave të tjera të komunikimit.
2. Kompetenca e Bordit për të përcaktuar nëse mjetet e mësipërme të komunikimit duhet të zbatohen për të kryer çdo takim të domosdoshëm në kushtet e Forcës Madhore do të varet nga kufizimet e legjislacionit shqiptar në fuqi në atë kohë të veçantë.

## **Neni 24**

### **Njoftim për shtyp/Deklarata Publik**

Çdo njoftim për shtyp ose deklarata publike të bëra nga çdo anëtar i Dhomës, përfshirë çdo anëtar të Bordit, në emër të Dhomës, miratohen paraprakisht nga Bordi. Pavarësisht sa më sipër, Drejtori Ekzekutiv kur vepron si përfaqësues i Dhomës do të lejohet që të bëjë deklarata publike pa pëlqimin paraprak të Bordit nëse, dhe vetëm nëse, (1) nuk është praktikisht e mundur marrja e pëlqimit paraprak për këto deklarata publike, dhe (2) Drejtori Ekzekutiv është në mirëbesim për përfaqësimin e politikave, pikëpamjeve dhe prioriteteve të Dhomës.

## **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 25**

#### **Likuidimi**

Pas shkrirjes, të gjitha asetet e mbetura të Dhomës do t'i jepen, me vendim të Asamblesë, një organizate jofitimprurëse, e cila ka të njëjtat qëllime me ato të Dhomës.

### **Neni 26**

#### **Nënshkrimi**

Statuti firmoset nga: **PRESIDENTI**